

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Për Enverin yll e dritë..." Korreshi bën "lëmsh" rrjetin, vajza që recitoi poezinë për diktatorin, e persekutu ar dhe e përndjekur! I ati e kishte shkruar poezinë me detyrim
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/per-enverin-yll-e-drite-korreshi-ben-lemsh-rrjetin-vajza-qe-recitoi-poe-i401659
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 09:20:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 09:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8e6963caae31fa4e915467866d79105c199d2ccc47cdcd0ccdb51f6a0bdc135c
TEKSTI	a452f1e5d1971f4d3a84eca9923ab91042d87e1a57b685ed657ff5e98c268bd5
PAMJA	fc68b0b80fe5939ad7640103ef99f75502641b595944749310fc29143e6929b2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eaec7881b566354ec5cb1f8eb321517a837f6fde5c37c220233df552bf92ce75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ead6d45cd661960fee24f4d1517566a9fcbaf897e8e6a5c5671cb3e2523303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eaec7881b566354ec5cb1f8eb321517a837f6fde5c37c220233df552bf92ce75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista



Kreu

Politikë

Aktualitet

Ekonomi

Kulturë & Art

Rajon

Sport

Bota

Showbiz

SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!


Politikë

20 Shtator 2026, 11:04

"Për Enverin yll e dritë..." Korreshi bën "lëmsh" rrjetin, vajza që recitoi poezinë për diktatorin, e persekutuar dhe e përndjekur! I ati e kishte shkruar poezinë me detyrim



Shkruar nga Newsbomb



Fotomontazh

Një video e publikuar një ditë më parë nga deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Korreshi, ka bërë "lëmsh" median dhe rrjetin, duke shkaktuar një valë reagimesh.

Në pamjet e shkëputura nga një aktivitet i zhvilluar në Bibliotekën e Qytetit të Lushnjës, ku poeti Neki Ngucaj promovoi kolanën e tij prej 18 librash me poezi, vajza e tij, u shfaq duke recituar një poezi ku teksa e dëgjoje të jepte përshtypjen se ishin duke u thurur lavde për diktatorin Enver Hoxha.

Mirëpo, mbrapa gjithë asaj poezie dhe atyre vargjeve fshihet një histori krejt tjetër.

Vajza e poetit që shfaqet në video është një prej katër vajzave të një familjeje të përndjekur nga regjimi komunist. Poezia që ajo recitoi nuk u soll si homazh për diktatorin, por si një kujtim ironik i një kohe kur nxënësit detyroheshin të recitonin e këndonin për Enver Hoxhën.

Madje, sipas rrëfimit të një komentueseje që pretendon se e njeh nga afër historinë e familjes, vetë poezia ishte shkruar nga i ati i saj, në atë kohë, pikërisht si një ironi ndaj diktatorit.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Hoqën dorë nga Franca, Italia dhe Tirana për të zhvilluar bizneset në Koman dhe Pogradec, Rama na prezanton me 3 sipërmarrës!



Aktualitet

DEL FOTO: Ky është "Tani i Ruzhdiut", 44-vjeçar që u qëllua me breshër plumbash në Sarandë, vjet u arrestua për plagosjen e Lamajt


Zbulu më shumë artikuj >

"O njerëz që komentoni pa ditur asgjë, më vjen keq sinqerisht. Këto vajza janë katër motra të një njeriu shumë të nderuar dhe të persekutuar deri në palcë nga ish-regjimi. Sot u promovuan librat që ka shkruar babai i tyre dhe kjo vjershë ishte e kohës kur ndërroi jetë diktatori. Vajza e recitonte para shkollës. Ishte nxënëse e dalluar, por pa të drejtë për të ndjekur shkollën e lartë nga sistemi", shkruan komentuesja ndër të tjera.

O njerëz që komentoni pa ditur asgjë, më vjen keq sinqerisht. Këto vajza janë 4 motra të një njeriu shumë të nderuar dhe të persekutuar deri në palcë nga ish-regjimi. Sot u promovuan librat që ka shkruar babai i tyre, dhe kjo vjersha ishte e kohës kur ndërroi jetë diktatori, vajza recitonte para shkollës ishte nxënëse e dalluar por pa të drejtë shkolle të lartë nga sistemi. Dhe vetë jati e kishte bërë këtë vjershë si ironi për vetë sistemin dhe vajza e recitoi para shkollës. Këtë e solli si një kujtim për ato vite e cila ishte detyruar ta recitonte. Gjyshi ja kanë pushkatuar kur jati ishte vetëm 10 vjeç, vajzat dhe pse me nota të shkëlqyera nuk kishin të drejtë shkollimi etj etj. Sot u promovuan librat dhe u sollën në kujtesë shumë vështirësi të kësaj familje, e cila jeton në Itali prej vitesh janë bërë të katërta me punë dhe janë integruar në shoqëri në fusha të ndryshme. Jane pedagogë kanë hapur kopsht në Bolzano

Komenti i bërë nga një qytetare e cila njihet nga afër familjen

Të kësaj mëtej ajo ka bërë me dije se edhe gjyshi i katër vajzave, ishte pushkatuar në regjimin komunist kur i biri, babai i tyre, ishte vetëm 10 vjeç. Më pas edhe vajzat e Neki Ngucajt, ndonëse me rezultate të shkëlqyera në mësim, u përballën me kufizimet që regjimi u vendoste familjeve të konsideruara "të deklasuar".



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Shtunë 20:23

“Ku gabuam?” Pandeli Majko bën thirrje për REFLEKTIM kolektiv pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK: Pse humbëm betejën me Serbinë? Tradhëtia, veç ngushëllim...



Politikë

Zhvillimi i Qëndrueshëm për 2026-ën, Rama flet me SHIFRA: Varfëria ka rënë në 19%, borxhi publik më poshtë se 60%

🕒 E Shtunë 17:03



Politikë

Tre ditë në Ballkanin Perëndimor, Ursula von der Leyen do të vizitojë Tiranën dhe Prishtinën

🕒 E Shtunë 07:42



🕒 E Premte 23:05

Ka shprehur ambicien për Bashkinë e Tiranës, Braçe bën premtimin e parë publik: Do të përshejtoji procesin e

legalizimit



Politikë

"Prania Besnike", Balluku takim me qytetarët e Fierit: Çdo javë, më shumë besim (FOTO)

🕒 E Premte 21:05



Politikë

U dërgua në spitalin privat, Erion Veliaj thyen këmbën pas ndeshjes së futbollit në paraburgim (DETAJE)

🕒 E Premte 18:47



🕒 E Premte 16:57

2 vite pa Gerti Bogdanin, vëllai e kujton i përmalluar: Zemrës herë i duket sikur asnjë ditë nuk ka kaluar... e herë i duket pafundësi



Politikë

Ervin Demo u betua sot te Presidenti, zëvendëskryeministria e pret në zyrë, Besfort Lamallari i dorëzon stafetën e Punëve të Brendshme

🕒 E Premte 15:49



Politikë

"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la", deputeti socialist humb bashkëshorten, rrëqeth me mesazhin për ikjen e Lorinës

🕒 E Premte 13:11





🕒 E Premte 11:49

Ligji i ri për pagat në drejtësi, Edi Rama me ftesë për magjistratët: Të ulemi në një tryezë dhe të gjejmë zgjidhje afatgjate, nuk duam konflikt



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.